



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr. 83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

RREGULLORE PËR LICENCIM DHE GARIM E FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

EDICIONI 2023/24

Qershor, 2023

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





Në bazë të Nenit 23, alineja 1.3. të Statutit të Federatës së Basketbollit të Kosovës, Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës më 19.06.2023, miraton këtë:

RREGULLORE PËR LICENCIM DHE GARIM E FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS EDICIONI 2023/24

Neni 1

Federata e Basketbollit e Kosovës, si organi i vetëm përgjegjës për organizimin e garave të basketbollit në të gjitha disiplinat e këtij sporti në territorin e Republikës së Kosovës, e harton këtë Rregullore nëpërmjet të cilës saktësohen të drejtat dhe obligimet e klubeve të basketbollit, shkollave të basketbollit dhe subjekteve tjera në territorin e Kosovës që merren në mënyrë të organizuar me basketboll.

Neni 2

Rregullorja përshkruan dhe rregullon të drejtat dhe obligimet e të gjithë anëtarëve të FBK-së, duke përfshirë këtu klubet, shkollat e basketbollit, shoqatat anëtare të FBK-së dhe atyre të themeluara nga FBK-ja, si dhe të gjitha organizatave që merren me sportin e basketbollit, e që nuk janë anëtare të FBK-së.

Neni 3

1. Rregullorja parasheh kriteret për licencim të subjekteve që merren me sportin e basketbollit dhe secili subjekt licencohet për veprimtari në përputhje me kushtet e parapara në këtë rregullore, të cilat i bashkëngjiten në formë të Annex-it kësaj Rregulloreje.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





2. Licencimi i klubeve është i përfshirë në Statutin e FBK-së, andaj klubet janë të obliguara ligjërisht të respektojnë kërkesat e programit të licencimit.

Neni 4

1. Licencimi i një klubi/shkolle dokumentohet me vendim të Bordit të FBK-së para fillimit të edicionit të ri. Për tu pajisur me licencë: klubet, shkollat e basketbollit dhe subjektet tjera në territorin e Kosovës që merren në mënyrë të organizuar me basketboll duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara nga Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës.

2. Licenca është valide për një edicion garues në basketboll dhe rinovohet më së voni 15 ditë para fillimit të edicionit në garën ose veprimtarinë ku bën pjesë subjekti që e posedon licencën.

3. Pa posedim të licencës, asnjë subjekt nuk mund ta ushtrojë të drejtën e pjesëmarrjes në ndonjë garë ose organizimit të ndonjë gare të basketbollit.

Neni 5

1. Federata e Basketbollit të Kosovës nëpërmjet kriterëve të përcaktuara për licencim të klubeve mëton që:

- 1.1.** Të profesionalizojë klubet;
- 1.2.** Të ngritë standardet e klubeve dhe vetë Federatës;
- 1.3.** Të përforcojë kredibilitetin e garave në nivel të klubeve;
- 1.4.** Të ketë paraqitje sa më të mirë para publikut.

Neni 6

1. Në edicionin 2023/24 kriteret për licencim të bashkëngjitura në formë të Annex-it të kësaj Rregulloreje do të aplikohen për klubet e Superligës së

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





Meshkujve, Ligës së Parë të Meshkujve, Superligës së Femrave dhe Ligës së Parë të Femrave. Është e rëndësishme që të gjitha klubet të zbatojnë kriteret për licencim me përpikëri, në mënyrë që të jenë shembull, jo vetëm për klubet e kategorive më të ulëta në basketboll, por për të gjitha sportet kolektive në Kosovë.

2. Federata e Basketbollit e Kosovës në edicionin 2023/24 do të përcaktoj kriteret, të cilat duhet të plotësohen nga klubet në mënyrë që të kenë të drejtë të marrin pjesë në edicionin e ri të garave.

Neni 7

1. Federata e Basketbollit e Kosovës do t'ia besojë Komisionit për Licencim shqyrtimin e aplikacioneve nga klubet për çdo edicion.

2. Federata e Basketbollit e Kosovës në rast nevoje do të kërkojë shërbime nga Komisioni Arbitrar në rast se paraqiten ankesa nga klubet që aplikojnë për licencim.

3. Federata e Basketbollit e Kosovës do të caktoj afat për klubet që të paraqesin dokumentacionin e tyre dhe përmbushjen e kriterëve. Federata e Basketbollit e Kosovës do të përgatitë formularët e aplikimit dhe dokumentet e tjera të nevojshme për klubet.

Neni 8

1. Kësaj Rregulloreje i bashkëngjiten në formë të Annex-it këto materiale:

- 1.1.** Kriteret e Përgjithshme (formulari).
- 1.2.** Kriteret e Pjesëmarrjes.
- 1.3.** Lista e Kontratave për lojtarët/et dhe trajnerët/et.
- 1.4.** Plani Financiar (shabllon).
- 1.5.** Organogrami i një klubi (shabllon).

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





Neni 9

Në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje, FBK i lëshon llojet e licencave të parapara më poshtë si dhe kushtet që duhet plotësuar për pajisjen me licencën përkatëse. FBK i lëshon 4 lloje të licencave dhe saktëson kushtet për marrjen e tyre.

Mjetet e inkasuara nga licencimet do të dedikohen për financimin e projekteve për zhvillim të gjeneratave të reja në të dyja konkurrencat.

LICENCA <A>

Licenca A lëshohet për klubet anëtare të Superligës së Kosovës (Meshkujt) dhe ekipet që përfaqësojnë Kosovën në garat ndërkombëtare në konkurrencën e seniorëve.

Kushtet:

1. Ta ketë ekipin anëtar të Superligës - rangut më të lartë të garave në sistemin e garave të FBK-së në kategorinë e seniorëve
2. Ta ketë në dispozicion me qasje të vazhdueshme një palestër të sporteve me terren të basketbollit sipas dimensioneve dhe rregullave të FIBA-s.
3. Ta ketë në dispozicion me qasje të vazhdueshme një palestër të sporteve me pajisjet teknike **FIBA Equipment**.
4. Ta ketë në dispozicion me qasje të vazhdueshme një palestër të sporteve me kosha të basketbollit me tabela dhe rrjeta sipas Propozicioneve të Garave të FBK-së dhe Rregullave të FIBA-s LEVEL 1.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





5. Ta ketë në dispozicion me qasje të vazhdueshme një palestër të sporteve me zhveshtore për dy ekipe, një zhveshtore për personat zyrtarë, një hapësirë të klubit me zyrë, të pajisur me telefon, internet dhe kompjuter.

6. Të ketë nën kontratë së paku **4** trajnerë të licencuar.

7. Të ketë në dispozicion së paku një person të autorizuar mjekësor.

8. Të ketë në dispozicion së paku një zyrtar për siguri.

9. Të ketë të licencuar së paku një përfaqësues zyrtar në FBK.

10. Të ketë internet dhe të mundësojë qasje në internet në dhe afër tavolinës zyrtare.

11. Të ketë hapësirë për konferenca për shtyp dhe tu mundësojë gazetarëve punë komode në ndeshjet e veta.

*Klubet që garojnë në Superligën e Meshkujve duhet të paguajnë shumën 3000 € depozit para fillimit të edicionit garues, nga e cila shumë 1.500,00€ ndahen në emër të kootizimit për edicionin **2023/2024**. Në rast se një klub nuk e kryen këtë obligim, humb të drejtën e garimit në Superligë.*

Bordi i FBK-së ka të drejtën e dhënies së "Wild Card" për secilin klub që përmbush kriteret për licencim dhe garim në Superligë, dhe paguan shumën prej 10,000.00 (dhjetë mijë) Euro, për të zëvendësuar ndonjë anëtar të Superligës, në rast se i humbet e drejta për garim, apo edhe për t'u bërë anëtar i Superligës për edicionin vijues me vendim të Bordit të FBK-së.

Pagesa vjetore për këtë licencë kushton:

- 5 €- për të gjitha klubet e Superligës që marrin pjesë me 4 e më shumë ekipe të gjeneratave të reja.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball supporters:



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr. 83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

- Në rast se klubi nuk merr pjesë me asnjë kategori (U14, U16, U18 e Minibasketboll) në garat e gjeneratave të reja, atëherë para fillimit të edicionit 2023/24, klubi duhet të deponojë në FBK shumën prej 10,000.00 (dhjetë mijë) Euro, të cilat FBK do ti vendos tek buxheti i Qendrës Nacionale të Basketbollit.
- Në rast se klubi merr pjesë me vetëm një kategori (prej tyre: U14, U16, U18 ose Minibasketboll) në garat e gjeneratave të reja, atëherë para fillimit të edicionit 2023/24, klubi duhet të deponojë në FBK shumën prej 7,500.00 (shtatë mijë e pesëqind) Euro, të cilat FBK do ti vendos tek buxheti i Qendrës Nacionale të Basketbollit.
- Në rast se klubi merr pjesë me vetëm dy kategori (prej tyre: U14, U16, U18 ose Minibasketboll) në garat e gjeneratave të reja, atëherë para fillimit të edicionit 2023/24, klubi duhet të deponojë në FBK shumën prej 5,000.00 (pesë mijë) Euro, të cilat FBK do ti vendos tek buxheti i Qendrës Nacionale të Basketbollit.
- Në rast se klubi merr pjesë me vetëm tri kategori (prej tyre: U14, U16, U18 ose Minibasketboll) në garat e gjeneratave të reja, atëherë para fillimit të edicionit 2023/24, klubi duhet të deponojë në FBK shumën prej 2,500.00 (dy mijë e pesëqind) Euro, të cilat FBK do ti vendos tek buxheti i Qendrës Nacionale të Basketbollit.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





LICENCA

Licenca B lëshohet për klube që kanë ekipe në rangjet më të ulëta se Superliga e Kosovës për Meshkuj.

Kushtet:

1. Ta ketë së paku një ekip anëtar në ndonjërin nga ligat e seniorëve të FBK-së.
2. Ta ketë në dispozicion me qasje të vazhdueshme një palestër të sporteve me terren të basketbollit sipas dimensioneve dhe rregullave të FIBA-s.
3. Ta ketë në dispozicion me qasje të vazhdueshme një palestër të sporteve me pajisjet teknike për mbajtjen e rezultatit të ndeshjes, kohës, kohës së aksionit (posedimit të topit) dhe gabimeve personale sipas standardeve të FIBA-s.
4. Ta ketë në dispozicion me qasje të vazhdueshme një palestër të sporteve me kosha të basketbollit me tabela dhe rrjeta sipas propozicioneve të FBK-së dhe rregullave të FIBA-s.
5. Ta ketë në dispozicion me qasje të vazhdueshme një palestër të sporteve me zhveshtore për dy ekipe, një zhveshtore për personat zyrtarë, një hapësirë të klubit me zyrë, të pajisur me telefon, internet dhe kompjuter.
6. Të ketë nën kontratë së paku **1** trajner të licencuar.
7. Të ketë në dispozicion së paku një person të autorizuar mjekësor.
8. Të ketë të licencuar së paku një përfaqësues zyrtar në FBK.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:



Pagesa vjetore për këtë licencë kushton:

- 5 €- për klub që ka ekip të seniorëve në ndonjë ligë të FBK-së dhe merr pjesë me dy ose më shumë ekipe të kategorive të reja në ligat për të rinj.

Minimum dy ekipe të kategorive të reja (prej U14, U16, U18 ose Minibasketboll) duhet të lajmërohen për gara nga secili klub i **Ligës së Parë të Meshkujve** dhe për secilin ekip duhet të jetë përgjegjës në letër një trajner/e i licencuar.

- Në rast se klubi nuk merr pjesë me asnjë kategori (prej tyre: U14, U16, U18 ose Minibasketboll) në garat e gjeneratave të reja, atëherë para fillimit të edicionit 2023/24, klubi duhet të deponojë në FBK shumën prej 5,000.00 (pesë mijë) Euro, të cilat FBK do ti vendos tek buxheti i Qendrës Nationale të Basketbollit.
- Në rast se klubi merr pjesë me vetëm një kategori (prej U14, U16, U18 dhe Minibasketboll) në garat e gjeneratave të reja, atëherë para fillimit të edicionit 2023/24, klubi duhet të deponojë në FBK shumën prej 2,500.00 (dy mijë e pesëqind) Euro, të cilat FBK do ti vendos tek buxheti i Qendrës Nationale të Basketbollit.

Minimum dy ekipe të kategorive të reja U16 dhe U18 duhet të lajmërohen për gara nga secili klub i **Superligës së Femrave** dhe për secilin ekip duhet të jetë përgjegjës në letër një trajner/e i licencuar.

- Në rast se klubi nuk merr pjesë me asnjë prej kategorive të lartpërmendura në garat e gjeneratave të reja, atëherë para fillimit të edicionit 2023/24 duhet të deponojë në FBK shumën prej 5,000.00 (pesë mijë) Euro, të cilat FBK do ti shfrytëzoj për zhvillim të basketbollit femëror në vendin tonë.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





- Në rast se klubi merr pjesë me vetëm një prej dy kategorive të lartpërmendura në garat e gjeneratave të reja, atëherë para fillimit të edicionit 2023/24 duhet të deponojë në FBK shumën prej 2,500.00 (dy mijë e pesëqind) Euro, të cilat FBK do ti shfrytëzoj për zhvillim të basketbollit femëror në vendin tonë.

Minimum një ekip të kategorive të reja U14 duhet të lajmërohet për gara nga secili klub i **Ligës së Parë të Femrave** dhe për secilin ekip duhet të jetë përgjegjës në letër një trajner/e i licencuar.

- Në rast se klubi nuk merr pjesë me asnjë kategori në garat e gjeneratave të reja, atëherë para fillimit të edicionit 2023/24 duhet të deponojë në FBK shumën prej 1,500.00 (një mijë e pesëqind) Euro, të cilat FBK do ti shfrytëzoj për zhvillim të basketbollit femëror në vendin tonë.

Klubet që garojnë në Superligën e Femrave, Ligën e Parë të Femrave, Ligën e Parë dhe të Dytë të Meshkujve duhet të paguajnë 150,00€ në emër të kootizimit për edicionin garues 2023/2024 dhe 150,00€ depozit para fillimit të edicionit garues.

Në rast se një klub nuk e kryen këtë obligim, humb të drejtën e garimit.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





LICENCA <C>

*** Licenca C është licencë e përkohshme dhe i lëshohet të gjitha tyre klubeve dhe shkollave të basketbollit që për shkak të grupmohës së ekipit/eve të paraqitura për gara, nuk ka asnjë ekip që garon në ndonjë ligë të seniorëve në garat e FBK-së. Kjo licencë ka validitet deri në përfundimin e sezonit të ekipit të grupmohës më të vjetër (juniorë) të këtij klubi/shkollë. P.sh: Nëse një shkollë kërkon/aplikon për licencë dhe ekipi i grupmohës më të madhe të saj është U-16, atëherë licenca vlen derisa ai ekip të përfundojë garimin në ligën U-18.**

Kushtet:

1. Të ketë së paku një ekip në ligat e kategorive të reja në liga te FBK-së.
2. Ta ketë në dispozicion me qasje të vazhdueshme (në baza ditore) një palestër të sporteve me terren të basketbollit sipas dimensioneve dhe rregullave të FIBA-s.
3. Ta ketë në dispozicion me qasje të vazhdueshme një palestër të sporteve me pajisjet teknike për mbajtjen e rezultatit të ndeshjes, kohës, kohës së aksionit (posedimit të topit) dhe gabimeve personale sipas standardeve të FIBA-s.
4. Ta ketë në dispozicion me qasje të vazhdueshme një palestër të sporteve me kosha të basketbollit me tabela dhe rrjeta sipas propozicioneve të FBK-së dhe rregullave të FIBA-s.
5. Ta ketë në dispozicion me qasje të vazhdueshme një palestër të sporteve me zhveshtore për dy ekipe, një zhveshtore për personat zyrtarë, një hapësirë të klubit me zyrë, të pajisur me telefon, internet dhe kompjuter.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





6. Të ketë nën kontratë së paku dy trajnerë të licencuar për 40 vijues të shkollës.

7. Të ketë në dispozicion së paku një person të autorizuar mjekësor.

8. Të ketë të licencuar së paku një përfaqësues zyrtar në FBK.

Pagesa vjetore për këtë licencë kushton:

*150€ kootizimi për edicionin garues 2023/2024 për të gjitha klubet e kategorive të reja.

* 50€ për klubin/shkollën që garon me së paku një ekip në të gjitha ligat e kategorive të reja në FBK.

* 100 € për klubin që garon në dy nga katër grupmoshat e reja në FBK.

* 150 € për klubin që garon në tri nga katër grupmoshat e reja në FBK.

* 200 € për klubin që garon në katër nga katër grupmoshat e reja në FBK.

(numri i ekipeve të kategorive të reja llogaritet në kumulativ për meshkuj dhe femra në rast se klubi ka ekipe të të dyja gjinive).

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





LICENCA <D>

Licena D lëshohet për të gjitha klubet, shoqatat dhe organizatat që nuk marrin pjesë në garat e FBK-së, por merren me organizimin e garave, turneve dhe ngjarjeve të basketbollit në të gjitha disiplinat të sportit (përfshirë 3x3, basketboll me karroca dhe disiplinat tjera).

Pagesa vjetore për këtë licencë kushton:

- * 5€ për subjektet që organizojnë gara të basketbollit me karroca.
- * 200€ për subjektet që organizojnë gara në disiplinat tjera të basketbollit.

Neni 10

1. Federata e Basketbollit e Kosovës në fillim të çdo edicioni do të informoj organet përkatëse shtetërore, si qeverinë qendrore (Ministrinë për Kulturë, Rini e Sport) dhe qeveritë lokale (komunat përkatëse) me listën e emrave të ekipeve të licencuara për edicionin vijues garues.

2. Organizimi dhe ushtrimi i aktiviteteve të basketbollit nga subjektet që nuk kanë licencë të FBK-së përbën shkelje të akteve normative të FBK-së dhe cilësohet si pengim i FBK-së në ushtrimin e veprimtarisë së vet.

Neni 11

FBK në bashkëpunim me Ministrinë për Kulturë, Rini dhe Sport të Kosovës, komunat përkatëse dhe organet tjera e merr përsipër që ti mbrojtë të drejtat e subjekteve të licencuara dhe të reagojë menjëherë në rast se veprimtaria e tyre pengohet nga subjekte të palicencuara.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:



Neni 12

Federata e Basketbollit e Kosovës është garantuese e validitetit të licencës para organeve të veta dhe organeve shtetërore dhe obligohet që licencat ti lëshojë në pajtueshmëri me këtë Rregullore.

Neni 13

1. Federata e Basketbollit e Kosovës e ruan të drejtën që të suspendojë ose tërheqë licencën/at e lëshuar/a në rast se konstatohen shkelje të kësaj rregulloreje nga bartësi i licencës.

2. Federata e Basketbollit e Kosovës e ruan të drejtën që të formojë Komisione dhe trupa të tjera inspektuese për veprimtarinë e bartësve të licencave.

Neni 14

1. Federata e Basketbollit e Kosovës ka të drejtë që pas çdo edicioni të bëjë evoluimin e kriterëve për licencim dhe garim, si dhe të kësaj Rregulloreje në tërësi dhe ta përditësojë ato me qëllim të zhvillimit dhe avancimit të anëtarëve të saj, por edhe gjithë basketbollit në vendin tonë.

Neni 15

Kjo Rregullore është e harmonizuar me Statutin e FBK-së dhe hyn në fuqi në ditën e miratimit.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr. 83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

E miratuar në Prishtinë më 19.06.2023.

Në emër të Bordit të FBK-së,

Kryetar
Arben **FETAHU**



Federata e Basketbollit të Kosovës

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:

